



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr: 168

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE,” NDAJ
ZJ. ERISELDA SEFA KANDIDATES PËR KRYETAR TË BASHKISË LUSHNJË,
ZJ. OGERTA MANASTIRLIU MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, Z. PERIN VOGLI DREJTOR I SPITALIT “IHSAN ÇABEJ”, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 19.05.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që i përket:

Kërkues: Organizata “Qëndresa Qytetare”

Objekt: Takim elektorale në ambientet e spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë, në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu
Kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa
Drejtorit të Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë, z. Perin Vogli

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 21, shkronja “dh” dhe 91, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave



Data: 19 Maj 2022

Nr. 168

“Për shqyrtimin e denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare,” ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryetarit dhe z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 26 Shkurt 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi me numër ID unik 3598, ku pretendohet se: *“Në datë 16.02.2022, në Spitalin e Lushnjës, konkretisht nën praninë e kandidatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, për kryetare të bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa, e cila aktualisht mban postin e Kryetares në detyrë, drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun e Fierit, z. Taulant Balla dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu, vizituan ambientet e Spitalit të Lushnjës me rastin e investimeve të zhvilluara në atë institucion spitalor. Ky aktivitet vjen në një kohë, që përkon me fushatën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në një veprimtari të ndaluar, në referim të nenit 3, pika 1.1/b të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ku kanë promovuar investimet me interes publik, aktivitet i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore”.*

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike nga takimi në Spitalin e Lushnjës si dhe provat në link.

Provat: Link:

<https://ëëë.facebook.com/114450444485182/posts/118339360762957/>

<https://ata.gov.al/2022/02/16/manastirliu-dhe-balla-investime-te-tjera-ne-spitalin-e-lushnjes/>

<https://fb.ëatch/bgMLyg8ËDS/>

<https://ëëë.facebook.com/b.taulant/posts/483537039804507>

<https://ëëë.facebook.com/OgertaManastirliu/posts/484024386427736>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
5. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi “Qëndresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj të denoncuarve zj. Eriselda Sefa Kryetar dhe kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnjë, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnje.

6. Referuar të denoncuarit deputetit z. Taulant Balla, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 2 e vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për këtë arsye nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.

II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator mbi *“Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*.

Në denoncimin e mësipërm pretendohet se, është kryer një takim që bie në kundërshtim me nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1297 prot., datë 28.02.2022, i është drejtuar zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu si dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, me shkresën nr. 1638 prot., datë 07.03.2022 Bashkisë Lushnjë, si dhe me shkresën nr. 1639 prot., datë 07.03.2022 z. Perin Vogli, Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë duke i kërkuar, informacion sqarues në lidhje me denoncimin e bërë nga organizata “Qëndresa Qytetare” në lidhje me organizimin e këtij aktiviteti.
9. Nëpërmjet shkresës me nr. 1099/1 prot., datë 04.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1297/1 prot., datë 04.03.2022, jemi informuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu në lidhje me organizimin e aktivitetit në Spitalin e Lushnjës, sipas së cilës, *“Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon se veprimtaria e denoncuar nuk është një veprimtari e ndaluar për t’u promovuar pasi për këtë lloj veprimtarie nuk janë vendosur nga MSHMS, rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo të jenë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor, të miratuar në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve, datës 06.03.2022.*

- a. *Ministria nuk është në kushtet e ndalimit ligjor pasi nuk ka marrë pjesë në veprimtari publike të ndaluar pasi aktiviteti ku ka marrë pjesë nuk është një veprimtari me karakter publik të hapur për pjesëmarrje nga publiku apo media”*.

10. NËPËRMJET SHKRESËS DATË 03.03.2022, PROTOKOLLUAR PRANË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE ME SHKRESËN NR. 1297/2 PROT., DATË 07.03.2022, JEMI INFORMUAR NGA KANDIDATI PËR Kryetar të Bashkisë Lushnjë zj. Eriselda Sefa, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” se: *“Prezenca e saj dhe e z. Taulant Balla në Spitalin e Lushnjës ka qënë tërësisht në funksion të premtimeve për zgjedhjet vendore në Lushnjë. Në vijim të fushatës dhe premtimeve zgjedhore nuk mund të shmangej takimi me qytetarët që marrin mjekim në spitale, pra ka qënë një takim elektoral gjatë së cilit nuk është bërë asnjë promovim i investimit apo rikonstruksionit të spitalit”*.
11. NËPËRMJET SHKRESËS ME NR. 1964/1 PROT., DATË 10.03.2022, PROTOKOLLUAR PRANË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE ME SHKRESËN NR. 1638/1 PROT., DATË 15.03.2022, JEMI INFORMUAR NGA Bashkia Lushnjë në lidhje me organizimin e aktivitetit në Spitalin e Lushnjës, sipas së cilës *“Në ambientet e Spitalit Lushnjë i cili ndodhet në territorin e Bashkisë Lushnjë ka qënë prezent Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një takim konsultues me mjekët specializantë të këtij spitali të cilët janë në përfundim të kontratës së tyre. Kryetarja në detyrë e Bashkisë Lushnjë ka qënë prezent në këtë takim për të ofruar ndihmën e Bashkisë Lushnjë duke ofruar bonusin e qirasë për banesat e mjekëve të cilët nuk janë me banim në Bashkinë Lushnjë. Kjo është një politikë sociale me anë të së cilës Bashkia Lushnjë do të japë kontributin e saj në pasjen e një stafi të specializuar në spitalin e Lushnjës dhe rrjedhimisht në një shërbim cilësor për shëndetin e banorëve”*.
12. NËPËRMJET SHKRESËS ME NR. 372 PROT., DATË 10.03.2022, PROTOKOLLUAR PRANË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE ME SHKRESËN NR. 1639/1 PROT., DATË 11.03.2022, JEMI INFORMUAR NGA Drejtori i Spitalit Lushnjë në lidhje me organizimin e aktivitetit në Spitalin e Lushnjës, sipas të cilit *“Nga ana e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte programuar për në datë 16.02.2022 ora 16:00, në ambientet e MSHMS një takim konsultues me gjithë mjekët sipas rajonit, që iu mbaronte kontrata në këtë periudhë. Duke qënë se po në datë 16.02.2022, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kishte në axhendë inagurimin e Qendrës Shëndetësore Gradishtë/Lushnjë, atëherë takimi u zhvillua në ambientet e Spitalit Lushnjë. Konfirmojmë se në këtë takim ka qënë e pranishme edhe kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë zj. Eriselda Sefa në cilësinë e përfaqësuesit të pushtetit vendor; për të garantuar një nga pikat e kontratës së mjekëve, bonusin e qerasë për banesat e mjekëve të cilët janë nga Tirana. Konfirmojmë faktin se nuk është bërë promovimi i investimeve të kryera në Spitalin Lushnjë, fokusi i takimit ka qënë konsultimi i kontratave të mjekëve specializantë të cilëve iu mbaronte kontrata në fund të muajt Mars 2022”*.

13. Nëpërmjet shkresës nr. 2121 prot., datë 11.04.2022, shkresat e sipërcituara u janë dërguar për njohje subjekteve zj. Eriselda Sefa, zj. Oligerta Manastirliu, z. Perin Vogli, Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Qëndresës Qytetare si dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 06.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjektet janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.
14. Brenda afatit të përcaktuar, organizata “Qëndresa Qytetare” ka paraqitur prapësimet e saj, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2200 prot., datë 20.04.2022, lidhur me pretendimet e paraqitura nga palët e denoncuar në vijim të përgjigjeve të tyre. Organizata “Qëndresa Qytetare” prapëson se, *“Zj. Sefa pranon në mënyrë të pakontestueshme që vizita në Spitalin e Lushnjës, ku kanë qenë present z. Balla dhe Ministri zj. Manastirliu, ka qenë tërësisht në funksion të fushatës zgjedhore. Po ashtu nga provat dhe faktet rezulton se ky aktivitet ka pasur në fokus investimet publike të bëra në Spitalin e Lushnjës, por jo vetëm. Vërehet qartë nga deklaratimet e bëra me shkresën nr. 1099/1 prot., datë 04.03.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shkresën nr. 1297/2, datë 07.03.2022 të Bashkisë Lushnjë, shkresën nr. 1964/1 prot., datë 10.03.2022 të Bashkisë Lushnjë dhe shkresën nr. 372 prot., datë 10.03.2022 të Drejtorit të Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë, se pretendimet nuk janë të bazuara në ligj dhe prova, duke shkelur kështu parashikimet e neneve 91, 92, 172 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2002 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator”.*
- Palët e tjera në proces nuk paraqitën prapësime.
15. Me vendimin nr. 149, datë 26.04.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, sepse hetimi administrativ rezultonte ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.
16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2268 prot., datë 27.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 28 Prill 2022, ora 12:00, me palë Organizata “Qëndresa Qytetare”, zj. Eriselda Sefa, zj. Oligerta

Manastirliu, z. Perin Vogli dhe Partisa Socialiste e Shqipërisë. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, organizata “Qëndresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti dhe drejtorja e spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë, me përfaqësues zj. Andoena Sulo, autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 582 prot., datë 27.04.2022, të drejtorisë së spitalit “Ihsan Çabej”, administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore.

17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësuesit të organizatës “Qëndresa Qytetare” dhe përfaqësuesit të drejtorisë së spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë. Përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare” deklaroi se, në datën 16 Shkurt, në spitalin e Lushnjës, në prezencën e kandidatës për kryetar bashkie zj. Eriselda Sefa, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu dhe drejtuesit politik të Partisë Socialiste të qarkut z. Taulant Balla, është zhvilluar një vizitë me rastin e investimeve të zhvilluara në këtë institucion. Ky aktivitet është kryer në periudhën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në veprimtari të ndaluara, promovojnë investime në interes publik dhe bëjnë premtime elektorale për rikonstrukcion të godinës, në prani të kandidatës Sefa. Në shkresën e përcjellë nga zj. Sefa thuhet se “në vijim të fushatës dhe premtimeve zgjedhore nuk mund të shmangnim as qytetarët që marrin kurim në spital”, duke konfirmuar karakterin elektoral të vizitës dhe sikurse rezultoi edhe nga deklaratimet e z. Balla, prezenca në spital ka qenë tërësisht në funksion të premtimeve për zgjedhjet vendore Lushnjë. Në këtë formë zj. Sefa, kandidatë për kryetar bashkie, pranon në mënyrë të pakontestueshme që kjo vizitë ka qenë në funksion të fushatës zgjedhore brenda një organi të administratës publike siç është spitali Lushnjë, e provuar kjo edhe nga pamjet filmike të vëna në dispozicion. Në referim të nenit 6, pika 3 të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, punonjësit të administratës publike i ndalohej të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. Në këtë rast, zj. Manastirliu në cilësinë e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka marrë pjesë në një veprimtari me karakter publik, në një kohë që përkon me periudhën zgjedhore. Prezenca e zj. Manastirliu implikon favorizimin e kandidatit.

Lidhur me pretendimet në parashtrimet e palës tjetër që vizita ka qenë për të takuar mjekët specializantë, në shkresën 372 prot., datë 10.03.2022 të drejtorit të spitalit, konfirmohet që ministrja e shëndetësisë, zj. Ogerta Manastirliu kishte në agjendë inagurimin e qendrës shëndetësore Gradisht, Lushnjë. Në referim të fakteve publike, lajmi i vizitës së ministres Manastirliu është publikuar në disa media online. Po t’i referohemi edhe pamjeve filmike të vetë

palëve në proces, në asnjë moment nuk janë përmendur mjekët specializantë por diskutimi shtrihet mbi investimet e reja në spital si dhe ka takuar edhe pacientët që merrnin kurim në atë spital.

Gjithashtu, kemi të bëjmë me një aktivitet i cili nuk rezulton të jetë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, duke shkelur kështu nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 4 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.

Për sa më sipër, përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare” kërkoi të konstatohet shkelja dhe të merren sanksione administrative ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu, drejtorit të spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë z. Perin Vogli dhe ndaj kandidatës për kryetar bashkie zj. Eriselda Sefa.

18. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi përfaqësuesit të drejtorisë së spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë të parashtrijë pretendimet e tij në lidhje me denoncimin. Përfaqësuesi i drejtorisë së spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë deklaroi se, në datë 15.02.2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka informuar drejtorinë e spitalit Lushnjë se do të zhvillohej një konsultim me mjekët specialistë të cilët përfundonin kontratën në Mars 2022. Duke qenë se në agjendën e ministres, në datën 16 Shkurt 2022 ministrja do inauguronte qendrën shëndetësore Gradisht, është bërë me dije se takimi me mjekët specialistë do zhvillohej në ambientet e spitalit Lushnjë. Për sa i përket kandidatës për kryetare bashkie zj. Eriselda Sefa, përfaqësuesi i spitalit Lushnjë pretendon se ka ardhur për të përmbushur një nga pikat më të rëndësishme të kontratës që është bonusi i qirasë për mjekët që jetojnë jashtë qytetit të Lushnjës.
19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare”, në përfundim të procesit administrativ, i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu, drejtorit të spitalit z. Perin Vogli dhe ndaj kandidatës për kryetar bashkie zj. Eriselda Sefa, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Zj. Andoena Sulo, në përfundim të procesit administrativ, kërkoi pushimin e shqyrtimit pasi pretendimet e ngritura nuk qendrojnë.

III. Analiza ligjore

20. Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*. Nga materialet e dosjes hetimore administrative

rezultoi se aktiviteti është kryer në datën 16.02.2022, me pjesëmarrjen e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu, deputetit z. Taulant Balla, Kryetarit dhe kandidatit për kryetar bashkie Lushnjë zj. Eriselda Sefa. Folësit kryesorë kanë qenë Ministri, Deputeti dhe Kryetari i Bashkisë Lushnjë.

21. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në Spitalin e Lushnjës, është një veprimtari **me karakter jo publik** pasi është kryer vetëm ndërmjet palëve të interesuara dhe institucioneve organizuese. Publikimi i takimit dhe informimi i publikut nëpërmjet Agjencisë Telegrafike Shqiptare si e vetmja agjenci zyrtare që informon publikun mbi aktivitetin e vendit, duhet të shihet në kuadër të **transparencës** së aktiviteteve të institucioneve publike.
22. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes u konstatua se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është paraqitur pranë një institucioni varësie, siç është dhe Spitali i Lushnjës, për të kryer **inspektimin e ambienteve të urgjencës** dhe të diskutonte për **marrëdhënien kontraktuale të punës me mjekët specializantë**. Nga ana tjetër, kryetari i Bashkisë Lushnjë do të paraqitej pranë këtij institucioni, në mënyrë që të diskutonte për ofrimin e bonusit të qirasë për mjekët specializantë, të cilët nuk janë me banim të përhershëm në bashkinë Lushnjë. Për sa ishte planifikuar nga ana e institucioneve të mësipërme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka njoftuar Drejtorin e Spitalit Lushnjë, z. Perin Vogli, për zhvillimin e aktiviteteve të mësipërme.
23. Veprimtaria e parashikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk përbën veprimtari të ndaluar pasi, Ministri si udhëheqës i veprimtarisë së aparatit kësaj ministrie, ka të përcaktuar në detyrat e tij funksionale (Neni 5 i rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, miratuar me urdhërin nr. 178, datë 22.02.2018) kryerjen e aktiviteteve të mësipërme. Institucionet publike nuk ndalojnë veprimtarinë e tyre gjatë periudhës zgjedhore dhe kryerja e detyrave të tyre funksionale nuk mund të shihet si veprimtari e ndaluar thjesht sepse është e kryer gjatë kësaj periudhe.
24. Kryetari i bashkisë Lushnjë, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, zj. Eriselda Sefa është paraqitur pranë Spitalit Lushnjë për të trajtuar/diskutuar rreth bonusit të qirasë për banesat e mjekëve, të cilët nuk janë me banim në Bashkinë Lushnjë. Kjo është një politikë sociale me anë të së cilës Bashkia Lushnjë jep kontributin e saj në pasjen e një stafi të specializuar në spitalin e Lushnjës dhe rrjedhimisht për një shërbim cilësor për shëndetin e banorëve. Veprimtaria e mësipërme nuk konsiderohet e ndaluar, pasi është në përmbushje të detyrave funksionale të

Kryetarit të Bashkisë. Megjithatë, në kundërshtim me çfarë ishte planifikuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkisë Lushnjë dhe Spitalit Lushnjë, (pa dijeninë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë) kryetarja e bashkisë njëkohësisht dhe kandidat për kryetar bashkie, e propozuar nga ana e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka shfrytëzuar këtë takim për kryerjen e fushatës zgjedhore në një institucion publik. Në statusin e kandidatit për kryetar, zj. Eriselda Sefa, shprehet se vizita e saj në Spitalin e Lushnjës është tërësisht në funksion të fushatës elektorale. Vendimi nr. 9/2020, i Komisionit Rregullator dhe ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor kanë pasur si qëllim të vetëm mospërdorimin e fondeve publike në funksion të fushatave elektorale të kandidatëve për kryetarë apo deputet.

25. Përkatësisht, neni 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”* Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9/2020 në nenin 3, pika 1.3, nëndarja c, qartësisht ka përcaktuar se 3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: *“vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.*
26. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se se zj. Eriselda Sefa, kandidat për Kryetar të Bashkisë Lushnjë, e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, **me përdorimin e ambienteve të Spitalit Lushnjë dhe me përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore** brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore dhe për kryerjen e takimit elektorale, ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore, në kuptim të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor.
27. Rezultoi e provuar nga materialet e dosjes se Drejtori i Spitalit të Lushnjës “Ihsan Çabej”, z. Perin Vogli, nuk ka pasur dijeni për kryerjen e fushatës elektorale nga ana e kandidatës për kryetare bashkie zj. Sefa në institucionin që ai drejton, megjithatë konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë se ky institucion, duhet të tregojë kujdes të shtuar për mospërsëritjen e rasteve të tilla.

28. Rezultoi e provuar se, veprimtaria e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, pasi zj. Manastirliu ka qënë në kryerjen e detyrave të saj funksionale. Kryerja e fushatës së zj. Sefa ka dalë përtej axhendës ndërinstitucionale dhe për atë që ishte dakordësuar. Në këto kushte, Ministria nuk ka qënë në dijeni që aktiviteti i organizuar do të përdorej për fushatë elektorale. Megjithatë, institucioni duhet të tregojë kujdes të shtuar për kryerjen e këtyre aktiviteteve, në mënyrë që të mos keqpërdoren për kryerjen e aktiviteteve të ndaluara të parashikuara në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
29. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*, dhe pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, vlerëson se zj. Eriselda Sefa, si subjekt zgjedhor në cilësinë e kandidatit për kryetar kryetarit të bashkisë, ka përdorur burime publike duke shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 21 shkronja “dh”, 91, dhe neni 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidat për Kryetar i Bashkisë Lushnjë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ndaj z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë.

2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e zj. Ogerta Manstirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga ana e z. Perin Vogli Drejtori i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë.
3. Konstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e zj. Eriselda Sefa, kryetar bashkie dhe njëkohësisht kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnjë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
4. T’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrativ.
5. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

